

## Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë në Shqipëri (SEJIII)

### Cili është qëllimi?

- ▶ Përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit publik të drejtësisë për qytetarët shqiptarë në përputhje me standardet dhe mjetet e CEPEJ.
- ▶ Të ndihmojë dhe kontribuojë në fushat kryesore të reformës në drejtësi, si statistikat gjyqësore, siguria e gjykatave, komunikimi me median, matja e kënaqësisë së përdoruesve të gjykatës.
- ▶ Mbështetja e Shkollës së Magjistraturës për t'iu përgjigjur nevojave në përputhje me procesin e reformës në drejtësi.

### Kush është përfitues i projektit?

- ▶ Aksioni do të mbështesë institucionet kryesore të drejtësisë si: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Ministria e Drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjykatat dhe përdoruesit e Gjykatave, Shkollën e Magjistraturës, Shkollën e Avokatisë.
- ▶ Qytetarët shqiptarë që do të marrin shërbime të përmirësuara në fushën e drejtësisë.

### Si do të punojë projekti?

Aksioni mbështetet në ekspertizën e ekspertëve të Komisionit European për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) dhe përvojën e tyre nga vende të ndryshme për të përmirësuar funksionimin e sistemit të drejtësisë me metodologjitë dhe mjetet e krijuara përkatësisht për Shqipërinë. Për të siguruar përparimin e qëndrueshëm dhe ndikimin e mbështetjes së reformës në drejtësi, Aksioni do të zhvillojë aktivitete të ndryshme si raportet e vlerësimit të nevojave, rekomandime specifike dhe zhvillimin e mjeteve për përmirësimin e zbatimit të tyre, projektet e mentorimit të gjykatave, seminare ndërjegjësimi dhe trajnime, vizitat studimore etj.

### Cilat janë rezultatet e pritshme?

- ▶ Përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve të drejtësisë ofruar qytetarëve shqiptarë.
- ▶ Përpunimin e statistikave gjyqësore në përputhje me standardet dhe mjetet e CEPEJ përmes një procesi të qëndrueshëm të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave të besueshme në të gjitha nivelet.
- ▶ Rritjen e kapaciteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës në përputhje me standardet dhe mjetet e CEPEJ për t'iu përgjigjur nevojave të procesit të reformës në drejtësi.

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës

## Cili është buxheti i projektit?

- ▶ Buxheti total i aksionit është 1,000,000.00 EUR
- ▶ Buxheti i alokuar në tërësi për Programin e Instrumentit Horizontal II arrin në 41 Million EUR (85% financuar nga Bashkimi Evropian, 15% nga Këshilli i Evropës)

## Ku mund të merrni informacion?

- ▶ Faqja e Internetit e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ): <https://www.coe.int/en/web/cepej/home>
- ▶ Faqja e Internetit e Instrumentit Horizontal: <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>
- ▶ Marija Simić, Oficere Komunikimi - Instrumenti Horizontal, [Marija.SIMIC@coe.int](mailto:Marija.SIMIC@coe.int), +381 63 601 337
- ▶ Besnik Baka, Oficer Komunikimi - Instrumenti Horizontal, [Besnik.Baka@coe.int](mailto:Besnik.Baka@coe.int), +355 69 217 8430

## Rreth Programit Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022" është një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson përfituesve të përbashkët agjendat e tyre të reformës në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe përputhjen me standardet evropiane, duke përfshirë aty ku është e nevojshme çështjet në kuadër të procesit të zgjerimit të BE-së. Ky program tre-vjeçar mbulon projekte në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Turqi, si dhe në Kosovë\* dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës prej majit 2019.

\* Ky përcaktim nuk përbën asnjë paragjykim për qëndrimin në lidhje me statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së dhe me Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

*Kjo fletëpalosje u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Qëndrimet e shprehura në të nuk shprehin domosdoshmërisht mendimin zyrtar të secilës palë.*

Financuar  
nga Bashkimi Evropian  
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet  
nga Këshilli i Evropës